Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Bashkangjitur paraqitet Projekti i zbatimit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT

"Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve në disa rrugë të lagjes 4 zona e re nën Mborje, si dhe në lagjen 8 rruga Ajet Gjndolli etj për UKKO Sh.A"

Zbatimi i punimeve të kanalizimeve të ujrave të përdorura në projektin "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve në disa rrugë të lagjes 4 zona e re nën Mborje, si dhe në lagjen 8 rruga Ajet Gjndolli etj për UKKO Sh.A" duhet të jetë në përshtatje të plotë me KTZ (Kushtet Teknike të Zbatimit) si dhe standardet për "Ndërtimin dhe provat e drenazheve dhe kanalizimeve të ujrave të përdorura".

Hapja e kanalit ku do të vendosen tubacionet.

Kanali hapet në vijë të drejtë sipas drejtimit të përcaktuar në projekt. Thellësia e tij duhet të jetë jo më pak se 10cm nën tubin që do të vendoset. Kanali pastrohet plotësisht dhe nuk duhet të ketë në të gurë ose mbetje të tjera mekanike. Fundi i kanalit duhet të jetë i gjerë jo më pak se 60cm plus diametrin e jashtëm të tubit. Këndi i ngritjes tërthore të kanalit mund të jetë deri në 15 gradë.

Vendosja e tubove.

Para se të vendoset tubi në kanal, në bazën e tij duhet të hidhet 10cm shtresë uniforme me rërë të imët. Mbi këtë shtresë vendoset tubi. Niveli i çdo tubi do të përcaktohet gjithmonë me instrument topografik. Ky proces është i domosdoshëm për të garantuar vetërrjedhjen, shpejtësinë dhe prurjen e llogaritur në projekt. Më pas kanali mbushet përsëri me rërë të imët deri 20cm mbi pjesën e sipërme të tubit. Pas këtij procesi hidhen rikthime (dhé) në shtresa nga 30cm. Çdo shtresë duhet të ngjshet me rul.Kompaktësimi i shtresave (gjatë mbulimit të tubit) do të kryhet me tokmak elektrik (çdo 30cm),duke eliminuar goditjen direkte mbi tub në 30centimetrat e parë. Mbushja e kanalit dhe gjendja e mirë teknike e tij do të kontrollohet për të qenë sa më e rregullt në lidhje me qëndrueshmërinë dhe penetrimin. Tubat lidhen njëri pas tjetrit me gomina hermetizuese. Lidhja me ngjitje ose me gomina duhet të jetë në përshtatje me standardin dhe t'i rezistojë presionit 0,5 bar. Tubat gjatë transportit, shtrirjes dhe lidhjes nuk duhet të pësojnë deformime ose çarje. Gjatë vendosjes së tubacioneve duhet të kryhen matje topografike për të garantuar pjerrësitë e përcaktuara në projekt.

Materialet mbushëse nuk duhet të kenë gurë ose ndonjë material tjetër të fortë që ka dimensione 150mm, në asnjë drejtim.

Kanalet në sipërfaqe do të jenë të risistemuara me materiale të njëjta si sipërfaqja origjinale e shtruar pasi Inxhinieri ka rënë dakord që instalimi është kompletuar. Anët e risistemimit do të priten në vijë të drejtë para se të jepet dora e fundit e rregullimit.

Atje ku është e mundur, do të përdoren materialet e zgjedhura nga germimi, dhe të hiqen gurët me madhësi mbi (>35mm) ose ndonjë objekt tjetër i fortë. Të gjithë materialet do të vendosen dhe do të ngjeshen me dorë ose me ngjeshës mekanik te përshtatshëm;

Fundi i kanalit duhet të jetë i qëndrueshëm.

Tubacionet

Tubat duhet të jetë korrugato të klasës SN 8 (8 KN/m²) të provuara në laborator dhe sipas standardit shqiptar.Guarnicionet që lidhin tubot duhet të jenë në përshtatje me standardin.

Diametrat e tubave do të jenë konform përshkrimit në preventivin përkatës.

Tubat e korruguara (DN315 dhe DN230)janë me mure të dyfishta: muri i jashtëm me rebra dhe muri i brendshëm me sipërfaqe të lëmuar.Shtresa e jashtme ka zakonisht ngjyrë të zezë kurse shtresa e brendshme duhet të jetë me ngjyrë të çelur.

Për lidhjet e shtëpive dhe pusetave të shiut do të përdoren tubo PVC 160mm,së bashku me rakorderitë përkatëse (bryla të ndryshëm, Ta etj.).


Tubot PVC do të jenë të pranueshme me koeficientin SDR 33.

Të gjitha llojet e tubove si ato të korruguara dhe ato PVC do të kenë të shënuara në trupin e tyre në mënyrë permanente karakteristikat e kërkuara:

-Klasa e tubit, koeficienti SDR, emri i prodhuesit etj.

Guarnicionet bashkues (Dn160) do të përdoren për lidhjen e tubacionit PVC DN 160, pra lidhjes së objektit me tubacionin kryesor(DN315) dhe shërben për fiksimin dhe hermetizimin e tubit PVC me tubin e korruguar. Këndi i takimit të tubit PVC me tubin e korruguar do të jetë 90 gradë(deri + 30 gradë sipas drejtimit të rrjedhës).

Tubat që do të përdoren duhet të jenë të pajisura me çertifikatat përkatëse që vërtetojnë cilësinë e tyre. Guarnicioni bashkues tip duhet të jetë si në figurë ose ekuivalent me të.



Pusetat e kontrollit b/a(1x1x1,5) m

Përmasat (1x1x1,5) m i referohen përmasave të brendshme të pusetave. Pusetat do të realizohen prej betoni të armuar duke lënë sipër një vrimë rrethore me diametër rreth 80 cm e cila mbyllet me suport dhe kapak gize me diametër 60cm. Lartësia e pusetës llogaritet duke mbetur kapaku i gizës në nivelin e sipërfaqes përfundimtare të shtresave të rrugës.

Në trupin e pusetës do të inkastrohen shkallë metalike. Shkallët do të përbëhen nga shufra hekuri me diametër Ø20 dhe thellësia e inkastrimit do të jetë 5 cm. Përmasat e shkallëve do të jenë (10x30) cm sipas detajeve të projektit të zbatimit.

Të gjitha punimet e betonit që do të kryhen për strukturat e pusetave, do të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me standardet shqiptare.

Shufrat e armimit duhet të ruhen dhe duhet të mbrohen me materiale kundër ndryshkut, demtimeve, vajit ose agjentëve të tjerë shkatërrues.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin e të gjithë shufrave të kerkuara nga Inxhinieri dhe të japë garanci për saktësinë para prerjes dhe lidhjes së hekurit të armuar.

Përzjerrësit do të përdoren vetëm me një aprovim me shkrim të Supervizorit, me qëllim që të modifikohen karakteristikat e betonit dhe të arrihen rezultatet.

Markat e betonit të përdorura në punime do të jenë sipas kërkesës ose me këshillat e Supervizorit.

Kallëpet

Te gjithë skeletet, kallëpet, mbështetësit, dhe vend kalimet do të jenë të një cilësie të përshtatshme dhe me të tillë fortësi që të jenë përsëri rigjide pa lënë ndonjë shtrembërim ose ndryshim gjatë gjithë formës, gjatë vibrimit dhe ngjeshjes së betonit. Drurë ose dërrasa me një trashësi më të vogël se 20 mm nuk do të përdoren pa një aprovim specifik të Supervizorit. Të gjithë lidhjet e kallëpeve duhet të jenë me mbyllje të përshtatshme për të shmangur humbjen e materialeve të imta ose të llaçit gjatë hedhjes dhe konsolidimit të betonit. Forma e kallëpit duhet të jetë e projektuar e tillë që të mund të lejojë lëvizjen e tij pa dëmtuar betonin.

Kontraktori do të duhet të japë një njoftim Supervizorit 24 orë më parë për të hequr çdo kallëp. Pasi betoni është formuar, kallëpet duhet të hiqen me shumë kujdes, pa goditje ose ndonjë prishje, në mënyrë që betoni të mos të dëmtohet. Asnjë kallëp nuk duhet të hiqet para se betoni të jetë formuar plotësisht për të shmangur çdo prishje të strukturës së betonit.

Në përgjithësi, betoni do të konsolidohet me vibratorë elektrik ose pneumatik. Vibrimi i cili shkakton ndarje të përbërësve ose një sipërfaqe të ujëzuar, ose e cila sjell një sasi të madhe të njomjes në sipërfaqe duhet të shmanget.

Për të gjithë llojet e pusetave bazamenti dhe kapaku prej gize duhet të jenë sipas standardit shqiptar.

Për të gjitha pusetat e kontrollit, për kapakët, rekomandohet tipi me ventilim, me menteshe, me diametër të jashtëm 610mm dhe lartësi 100mm.

Kapakët do të vendosen në nivelin dhe pjerrësinë përfundimtare të sipërfaqes së rrugës.

Nuk duhet të kryhen ndryshime të projektit gjatë zbatimit të tij. Në rastet kur është e domosdoshme duhet që këto të miratohen me shkrim nga klienti dhe supervizori i punimeve.

Pusetat e kontrollit b/a (0,8x0,8x1) m

Do të realizohen prej betoni të armuar. Ato do të realizohen me beton të armuar duke lënë sipër një vrimë katrore me brinjë rreth 40 cm e cila mbyllet me kapak betoni të mbështetur mbi murin e pusetës. Ky kapak hapet me krahë duke e ngritur lart me litar ose me kavo të lidhur në ganxhat metalike të tij. Lartësia e pusetës llogaritet duke mbetur kapaku i betonit në nivelin e sipërfaqes përfundimtare të shtresave të rrugës.

Të gjitha punimet e betonit që do të kryhen për strukturat e pusetave, do të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me standardet shqiptare.

Shufrat e armimit duhet të ruhen dhe duhet të mbrohen me materiale kundër ndryshkut, demtimeve, vajit ose agjentëve të tjerë shkatërrues.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin e të gjithë shufrave të kerkuara nga Inxhinieri dhe të japë garanci për saktësinë para prerjes dhe lidhjes së hekurit të armuar.

Përzjerrësit do të përdoren vetëm me një aprovim me shkrim të Supervizorit, me qëllim që të modifikohen karakteristikat e betonit dhe të arrihen rezultatet.

Markat e betonit të përdorura nëpunime do të jenë sipas kërkesës ose me këshillat e Supervizorit.

Kallëpet

Te gjithë skeletet, kallëpet, mbështetësit, dhe vend kalimet do të jenë të një cilësie të përshtatshme dhe me të tillë fortësi që të jenë përsëri rigjide pa lënë ndonjë shtrembërim ose ndryshim gjatë gjithë formës, gjatë vibrimit dhe ngjeshjes së betonit. Drurë ose dërrasa me një trashësi më të vogël se 20 mm nuk do të përdoren pa një aprovim specifik të Supervizorit. Të gjithë lidhjet e kallëpeve duhet të jenë me mbyllje të përshtatshme për të shmangur humbjen e materialeve të imta ose të llaçit gjatë hedhjes dhe konsolidimit të betonit. Forma e kallëpit duhet të jetë e projektuar e tillë që të mund të lejojë lëvizjen e tij pa dëmtuar betonin.

Kontraktori do të duhet të japë një njoftim Supervizorit 24 orë më parë për të hequr çdo kallëp. Pasi betoni është formuar, kallëpet duhet të hiqen me shumë kujdes, pa goditje ose ndonjë prishje, në mënyrë që betoni të mos të dëmtohet. Asnjë kallëp nuk duhet të hiqet para se betoni të jetë formuar plotësisht për të shmangur çdo prishje të strukturës së betonit.

Në përgjithësi, betoni do të konsolidohet me vibratorë elektrik ose pneumatik. Vibrimi i cili shkakton ndarje të përbërësve ose një sipërfaqe të ujëzuar, ose e cila sjell një sasi të madhe të njomjes në sipërfaqe duhet të shmanget.

Për të gjithë llojet e pusetave bazamenti dhe kapaku prej betoni duhet të jenë sipas standardit shqiptar.

Kapakët do të vendosen në nivelin dhe pjerrësinë përfundimtare të sipërfaqes së rrugës.

Nuk duhet të kryhen ndryshime të projektit gjatë zbatimit të tij. Në rastet kur është e domosdoshme duhet që këto të miratohen me shkrim nga klienti dhe supervizori i punimeve.

Pusetat e shiut b/a (40x40) cm h=100 cm

Do të realizohen prej betoni të armuar. Ato do të realizohen me beton të armuar duke lënë sipër një vrimë katrore me brinjë rreth 40 cm e cila mbyllet me kapak zgarë hekuri të mbështetur mbi murin e pusetës. Trupi i pusetës do të ndërtohet mbi linjën e tubacioneve që përcjellin ujrë të shiut. Lartësia e pusetës llogaritet duke mbetur kapaku i zgarës së hekurit në nivelin e sipërfaqes përfundimtare të shtresave të rrugës.

Të gjitha punimet e betonit që do të kryhen për strukturat e pusetave, do të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me standardet shqiptare.

Shufrat e armimit duhet të ruhen dhe duhet të mbrohen me materiale kundër ndryshkut, demtimeve, vajit ose agjentëve të tjerë shkatërrues.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin e të gjithë shufrave të kerkuara nga Inxhinieri dhe të japë garanci për saktësinë para prerjes dhe lidhjes së hekurit të armuar.

Përzjerrësit do të përdoren vetëm me një aprovim me shkrim të Supervizorit, me qëllim që të modifikohen karakteristikat e betonit dhe të arrihen rezultatet.

Markat e betonit të përdorura nëpunime do të jenë sipas kërkesës ose me këshillat e Supervizorit.

Pusetat do të ndërtohen mbi linjën e tubave të ujrave të shiut sipas detajeve të projektit.

Kapakët (zgara e hekurit) do të vendosen në nivelin dhe pjerrësinë përfundimtare të sipërfaqes së rrugës.

Nuk duhet të kryhen ndryshime të projektit gjatë zbatimit të tij. Në rastet kur është e domosdoshme duhet që këto të miratohen me shkrim nga klienti dhe supervizori i punimeve.

Standardet (Referencat)

Standardet e referencës janë ato shqiptare dhe standardet e vendeve të Bashkimit Europian EEC që konsiderohen si ekuivalente.

Sidoqoftë Sipërmarrësi për standardet që ai mendon të përdorë duhet më parë të bjerë dakord me Supervizorin përpara fillimit të punimeve.

Të gjitha materialet dhe komponentet përbërëse do të jenë të çertifikuara sipas standardeve Shqiptare dhe të gjitha prodhimet do të jenë konform Standardeve Kombëtare të ngjashme ose Kodet Praktike. Kontraktori mund të propozojë standarde alternative kombëtare te alternativave të propozuara të cilat duhet t'i paraqiten Supervizorit për rishikim dhe aprovim. Një kopje e të gjithë standardeve të aprovuara do të mbahen në kantier nga Kontraktori. Në qoftë se nuk ka Specifikime të Standardeve të publikuara, materialet dhe prodhimet do të jenë nga standardet më të përshtatshme dhe do të jenë subjekt për aprovim nga Supervizioni. Kur punimet e propozuara lidhen me rrjetet ekzistuese materialet e reja do të jenë të përshtatshme me ato ekzistueset.

Paketimi per Transport, Ruajtja dhe magazinimi

Përpara dërgimit prej fabrikës në objekt të gjitha materialet do të jenë të mbrojtura mjaftueshëm me mënyra të aprovuara për të gjithë periudhën e tranzitit, magazinimit, si dhe të eliminohen demtime aksidentale. Kontraktori do të jetë përgjegjës për paketimin nga fabrika, për mbrojtjen në mënyrë që materialet të arrijnë në vend të pa dëmtuara. Shkarkimi do të bëhet nga kontraktori (për shkarkimin e materialeve të furnizuara në vend ose magazinë) dhe ai është përgjegjës për ndonjë dëmtim.

Magazinimi në vend dhe mbajtja duhet të realizohen në mënyrë sa më të sigurt të jetë e mundur, dhe materialet që do të magazinohen të hapura në vend që të mos dëmtohen (Sigurimi i një magazine të aprovuar, mund të shihet si alternativë).

Ngarkimi dhe shkarkimi do të bëhen ngadalë me paisje të përshtatshme dhe tubacioni duhet të jetë nën kontroll gjatë gjithë kohës. Në asnjë rast nuk duhet që tubacioni të përplasët ose të hidhet nga lartësitë. Nëçdo rast duhet të përdoren rekomandimet e prodhuesit të tubave.

Inspektimi i Vendit

Para përgatitjes për të filluar punimet (nëse kërkohet) Kontraktori do të vizitojë Objektin dhe do të verifikojë gjendjen aktuale në krahasim me vizatimet e përgatitura, duke kontrolluar të gjithë dimensionet e rendësishme, rrugët e hyrjes, gjendjen e objektit dhe kërkesat në mënyrë që të sigurohet se të gjithë materialet dhe fuqia punëtore do të arrijë plotësisht sipas parashikimit të vizatimeve dhe Kontratës.

Përpara fillimit të punës Kontraktori do të ekzaminojë dhe të bëjë organizimin me Supervizionin që pajisjet të instalohen pa ndërhyrje me punet në vazhdim të konstruksionit dhe mund të shpërndajë në vend të gjitha materialet e listuara të kërkuara.

Kontraktori do të instruktrohet nga stafi i Supervizionit, për të marrë përgjegjësitë në të gjitha çështjet dhe gjërat që kanë të bëjnë me operimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e paisjeve dhe materialeve në kushte të përshtatshme.

Mbrojtja e shërbimeve dhe e veprave ekzistuese

Kontraktori do të njihet me pozicionin e të gjithë shërbimeve ekzistuese të tilla si rrjeti i ujësjellësit, lidhjet e banesave, sistemet ujitëse, drenazhet dhe kanalet e kullimit të ujrave sipërfaqësore, kabllat elektrike dhe të telefonit, shtyllat telefonike dhe të ndriçimit, tubacionet dhe të ngjashme me to përpara se të filloje ndonjë germim ose punë tjetër që mund të ndikojë këto shërbime. Kontraktori do të konsiderohet përgjegjës për dëmtimet e veprave dhe shërbimeve ekzistuese, dhe do të çdëmtojë Punëdhënësin për çdo ankesë në lidhje me këtë (duke përfshirë humbjet që pasojnë). Kontraktori do të jetë përgjegjës për risjelljen në gjendjen e mëparshme të shërbimeve që janë ndikuar.

Në të gjithë rastet kur këto vepra ose shërbime janë ekspozuar, ato duhet të mbrohen në mënyrë të përshtatshme, mbështeten ose mbrohen në ndonjë mënyrë tjetër.

Kujdes i veçantë duhet ushtruar në mbushjen dhe ngjeshjen e tokës nën tubacionet kryesore të rrjetit të ujësjellësit, kabllot, kanalet ujitëse etj. dhe të lihen të pa mbuluar çdo mates uji i ekspozuar, pusët, valvoldhe të tjera si këto. Gjithë kostot që mund të rezultojnë nga Kontraktori si rezultat i punës programuese koordinuese për të bërë të mundur të bëhet çdo ndryshim këtyre shërbimeve, dhe kosto e çdo mase parandaluese do të gjykohen nga Supervizori nëse është e nevojshme, në sajë të afërsisë së veprave nga çdonjëra nga shërbimet e kontraktorit. Disa nga detajet e kryqëzimeve me infrastrukturën e lartpërmendur do të jepen me vizatime.

Shmangia e shërbimeve ekzistuese

Menjëherë pasi kërkesa është bërë e njohur, kontraktori do të jetë përgjegjës për organizimin, në bashkëveprim me autoritetet përkatëse, për lëvizjen ose alterimin (ndryshimin) e shërbimeve ekzistuese të tilla si linjat elektrike dhe telefonike, linjat kryesore të ujit të pijshëm, tubacionet, kanalet ujitës, dhe drenazhet e ujit sipërfaqësor, të cilat ndikohen nga vepra. Organizimi për një lëvizje ose alterim (ndryshim) të tillë do të jetë me kusht të rënies dakord me Supervizorin dhe me autoritetet përkatëse në zërat e çmimeve të preventivit; në këtë kuadër devijimi i shërbimeve ekzistuese nuk do të jetë subjekt i ndryshimit të çmimit total të kontratës.

Të gjitha materialet, punimet e tokës, shtrimi, lidhjet dhe rakorderitë dhe prova e tubacioneve do të plotësojnë me detaje të gjithë kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Të gjitha materialet duhet të jenë të reja dhe të papërdorura.

Të gjitha tubat dhe rakorderitë duhet të jenë të inspektuara me kujdes, në kohën që arrijnë në objekt nga Kontraktori. Çdo material me difekt duhet të vendoset mënjane për inspektim nga Supervizori; ato duhet ose të riparohen ose të zëvendësohen sipas instruksionit të dhënë nga Supervizori

Të gjithë difektet do të jenë të identifikuara dhe do të riparohen me shpenzimet e Kontraktorit.

Hartoi:

Ilir Papa	Inxhinier i DIT
Thoma Koroveshi	Inxhinier hidroteknik

[illegible]

"Sotir Kuneshka" dhe lidhjet e rrjetit në rrugën "Asdreni"												
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Hartoi:

Ilir Papa

Inxhinier i DIT

Thoma Koroveshi

Inxhinier hidroteknik

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave **dhe tatimeve**, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

K. Lapi

I. Papa

Th. Koroveshi

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*
- b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ,me vlerë 334.600 (treqindetridhjetëekatërmijëegjashtëqind) lekë (2% të vlerës së përllogaritur të kontratës).*
- c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1.*
- d. *Formulari Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit, sipas Shtojcës 2.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 16.730.000 lekë.

2.2 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. N.P – 7 A (Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje)
- b. NP – 1 A (Punime gjurmimi në tokë).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 8.365.000 lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 33.460.000 lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndertimi ;

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

kontratë pune të vlefshme dhe diplomë.

2.3.3. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

a. 1 (një) Inxhinier Gjeodet ose 1 (një) teknik topograf

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

kontratë pune të vlefshme dhe diplomë.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/ të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. Gjashtë hidraulikë
- b. Katër Karpentierë
- c. Katër Hekurkthyes
- d. Dy Teknik të mesëm ndërtimi
- e. Pesë punonjës manovratorë të mjeteve të rënda.
- f. Dy shoferë
- g. Pesë punëtorë për gërmime me krahë

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve/ apo dëshmi aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në toke e lëshuar nga DPSHTRR , si dhe kontratat e punës të vlefshme.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën kohore : Janar 2022 –Shkurt 2022- Mars 2022, për punësimin e mesatarisht 25 personave”

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Statusi	Sasia
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
Minifadrome me goma (bobcat apo ekuivalente)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion vetshkarkues me tonazhe te ndryshme	në pronësi ose me qira	Copë 2
Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamionçinë deri në 6 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Gjenerator 15 kW	në pronësi ose me qira	Copë 1
Pompë për largimin e ujrave nga kanali me kapacitet mbi 10 l/s	në pronësi ose me qira	Copë 1
Tokmak elektrik	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1

I. Papa

Th. Koroveshi

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (I vlefshëm).

Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumentit qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(I vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt I ketij prokurimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor UKKO SH.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga OE.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme: ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilesisë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme: ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme: ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
 (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

--	--	--	--

• **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat <u>dhe tatimeve</u> dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

--

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	Po [] Jo []

8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me : a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	Po [] Jo []
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATAMBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata
